

se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mesím, që të çkujdësemi për trup, se shkon me nxitím, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gëzohet tok me Engjëjste, o Mark Oshenár i lumur lavdí me ty.

30. *Joani, Ati ynë Oshenár, auktori i Shkalles.*

PERLESHORJA E JOANIT TË SHKALLES,
T. T. IV, ORTHODOKSIAS ODHIJE

Udhëheqës Orthodóks, dhe mesonjës i besës dhe i përkores je, se na ke ndritur si një yll, dhe u-tregove si shembell e Kryepriftërve, i urtë Shen Joán, të gjithë i ndriçove dhe i mësove ti, lira e Shpirtit Shenjt. Lutju Krishtit Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

31. *Ipatí, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Gangres.*

TË KREMTET E PRILLIT

1. *Maria Egiptiana, Nena jone Oshenare.*

PERLESHORJA E MARISË EGIPTIANES,
T. T. IV, EN SI MITER AKRIVOS

Ti o Nënë pikerísht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mesím, që të çkujdësemi për trup, se shkon me nxitím, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gë-

zohet tok me Engjejte, o Marí Egiptiane lavdí me ty.

2. *Titoja, Ati yne Oshenár dhe çudíberes.*

3. *Nikita, Ati yne Oshenár, abati i Medikes; Josefi Hymnografi.*

PERLESHORJA E NIKITES SË MEDIKES,
T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Ate pikerisht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mesím, që të çkujdësemi për trup, se shkon me nxitím, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gezohet tok me Engjejte, o Oshenár Nikite i lumur lavdí me ty.

PERLESHORJA E JOSEFIT HYMNOGRAFIT,
T. T. IV, ORTHODOKSIAS ODHIFE

Udheheqës Orthodóks, dhe mesonjes i besës dhe i përkores je, se na ke ndritur si një yll, dhe u-tregove si shembell e Kryeprifërve, i urtë Shen Joséf, të gjithë i ndriçove dhe i mesove ti, lira e Shpirtit Shenjt. Lutju Krishtit Perendí, të shpetohen shpirtet tona.

4. *Gjergji i Malese, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E GJERGJIT TË MALESE,
T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Ate pikerisht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mesím, që të çkujdësemi për

trup, se shkon me nxitim, dhe te kujdesemi per shpirt, se eshte i pavdekur; pra shpirti yt po gezohet tok me Engjejte, o Ate Gjerq i lumur lavdi me ty.

5. *Klavdi dhe Diodori, Deshmoret e Shenjte.*

6. *Eftiku, Ati yne Oshenar, kryepeshkopi i Kostandinopjes.*

7. *Kaliopi, Deshmori i Shenjte.*

PERLGSHORJA E SHEN KALIOPIT, T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmoret e tu o Zot, me vajtje lot e mundim, kurore te ndrime prej teje mumarne, si roge dhe si qperblim; se me fuqine tende, i rrezuan tiranet; edhe i shtypne djajte, e kuximt' e te dobet; ata per ne po te luten o Krisht Perend, te shpetohen shpirtet tona.

8. *Herodioni, Agabi, Rufi, Asinkreti, Flegonti dhe Hermeu, prej te Shtatedhjetje Apostujve.*

9. *Eupsiku i Kesarise, Deshmori i Shenjte.*

10. *Terenti, Pompeji dhe shoket e tyre, Deshmoret e Shenjte.*

11. *Antipa, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Pergames.*

12. *Basili, Ati yne Oshenar, peshkopi i Paros.*

PERLGSHORJA E BASILIT TE PAROS, T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Ate pikerisht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht,

dhe vepra çfaqe për mesim, që të ڪujdësemi për trup, se shkon me nxitim, dhe të kujdësemi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gëzohet tok me ڪngjçjtë, o Shen Basíl i lumur lavdí me ty.

13. *Martini, Ati ynë i Shenjtë, Papa i Romës.*

PERLESHORJA E SHEN MARTINIT,
T. IV, KANONA PISTEOS

Kanun i besës, edhe kor' e butesisë, mesonjes i perkores, ndrite përpara besnikëve, me të verteten e punëve; perandaj i fitove me perunjësine të lartat, me varferinë të pasurat. At' i lavderuar Patrik Martín, lutju Zotit Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

14. *Aristarku, Pudi dhe Trofimi, prej të Shtatedhjetë Apostujve.*

15. *Kreskenti, Deshmori i Shenjtë.*

16. *Agapa, Irena dhe Kionia, Deshmoret e Shenjta, Virgjërësha dhe motra.*

PERLESHORJA E SHEN IRENËS,
T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmoret e tua o Zot, me vajtje lot e mundim, kurorë të ndriçime prej teje múnarë, si roge dhe si çpërlim; se me fuqinë tënde, i rrezuan tiranët; edhe i shtypnë djajtë, e kuximt' e të dobet; ató për në po të luten o Krisht Perendí, të shpëtohen shpirtet tona.

17. *Simeoni i Persides, Hierodeshmori i Shenjtë.*

PERLESHORJA E SIMEONIT TË PERSIDËS,
T. IV, TAKHI PROKATALLAVE

Deshmori yt o Zot, me vojtje lot e mundím, kurorc te ndrícime prej teje mori sot, si roge dhe si çperblím; se me fuqinë tende, ka rrezuar tiranet, dhe ka dermuar djajtë, e kuxímt' e te dobet; aý për né po te lutet o Krisht Perendí, te shpëtohen shpirtet tona.

18. *Joani, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E JOANIT OSHENARIT,
T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Atë pikerísht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mesím, që te çkujdésëmi për trup, se shkon me nxitím, dhe te kujdésëmi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gëzohet tok me Çngjējte, o Shen Joán i lumur lavdí me ty.

19. *Pafnuti, Hierodeshmori i Shenjte.*

20. *Theodori i Trikinës, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E THEODORIT TË TRIKINËS,
T. T. IV, EN SI PATER AKRIVOS

Ti o Atë pikerísht, u-tregove shembell e Zotit, se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht, dhe vepra çfaqë për mesím, që te çkujdésëmi për trup, se shkon me nxitím, dhe te kujdésëmi për shpirt, se është i pavdekur; pra shpirti yt po gë-

zohet tok me Ɖngjete, o Theodór i lumur lavdí me ty.

21. *Jenari, Deshmori i Shenjte, me shoket.*

22. *Theodori Sikeoti, Ati yne Oshenár.*

PERLESHORJA E THEODORIT SIKEOTIT, T. IV.

U-tregove i Shenjte prej foshnjerrise, i stolisur me hiret e miresise; boten e mbushe me driten e shénjave, dermove çetat e gjithë demóneve, o i bekuar Theodór; pra lutju Zotit Krisht, qe te meshiróhemi.

23. *Shen Gjergji Tropeprúresi, Deshmori i Math i lavderuar.*

PERLESHORJA E SHEN GJERGJIT, T. IV.

Si çlirimtár i róberve dhe mprojtes i te vobé-keve, mjeku i te semúreve dhe perlufatár i mbré-terve, Deshmór i Math Shen Gjerg Tropeprurcs, nermjetó perpara Kristit Perendí, te shpetohen shpirtet tona.

THIRRTORET, T. I, TON URANION

Prevera dhe e verteta po na shkelqejne sot, me bese dhe me shprese perscitet krijesa, prej Krishtit jetedhenes dhe Shpetimtár, se Shen Gjergji Deshmór i Math, i frymesuar me bese dhe trimeri, i dermój gjith' armíqt' e tij.

Ushtár i Mbretit te qellit ke qene o Shen Gjerg, dhe gjithë ushterite kundreshtare i munde, u-çfa-qe kryetrím i Krishtit me nam, me dhuraten e

Shpirtit Shenjt, edhe me hirin e Zotit bere çudi, nermjetó edhe shpëtona pra.

U fal shcrime atyre, qe te kerkojne hir, Shen Gjerq Deshmór i lumur, si per shpirtet dhe trupet, te gjithë i perkráh sa vijne me zell, dhe perikin me bes' e mall, dhe lypin mprojtje prej teje nga çdo rezík, o kurore e Deshmóreve.

LAVDI, T. I. Ke vepëruar sipas emrit, o Shen Gjerq ushtár i Krishtit: E more Kryqin mi supet, i çkule drizat e pagáncve, e lerove vreshten, dhe solle peme te shuma per besniket. Pra nermjetó per paqen e botës, dhe per shpëtimin e shpirtëve tona.

TANI, e *Pesedhjetores*.

PASVARGJET, T. II, IKOS TU EFRATHA

Mblídhuni sot ketú, Shen Gjergjin ta kremtojmë, se i durój mundimet, dhe e fitój kuroren, dhe lutet gjithënjé per né.

Lum' ti o kryetrím, Shen Gjerq i lavderuar, per gas u-vlerësove, prej Krishtit jetedhenes, si nje Deshmór i Math me nam.

O gjenerál i math, Shen Gjerq i lavderuar, gezohu se je mprojtje, perikje dhe perkrahje, dhe mburrje e besnikëve.

LAVDI. Mprona nga çdo rezík, prej ngásjeve t' armikut, qe na mundojne shpirtin, edhe na nxijne jeten, Shen Gjerq Deshmór i Math me nam.

TANI, e *Pesedhjetores*.

NDËNJËSORET, T. I, TON TAFON SU

Na lindi me gëzím, ver' e embel e hirit, na ndriti me lavdí, Pashk' e Madhe për boten, dhe ja taní na shkëlqén, dit' e kremte e ndrícime, plot me lavderím, e kryetrimt të Krishtit, eni gjithë pra, qe ta kremtojmë me besë, Dëshmorin e Math Shen Gjerq.

LAVDI DHE TANI, *e Pesedhjetores.*

T. III, THIAS PISTEOS

Plot me bes' e mall, për Shpëtimtarin, dhe me flag' e zell, i frymësuar, i dermove statujat e pagáneve; dhe në arenë dëshmove për Zotin Krisht, o kryetrím i trishlumur Shen Gjerq i Math; o Dëshmór me nam, përpara Perëndisë nermjetó, tu falë besníkeve meshire dhe shpëtim.

LAVDI DHE TANI, *e Pesedhjetores.*

T. IV, KATEPLLAJI IOSIF

Si lerove me kujdës, çdo porrosí të Zotit Krisht, e përdave mallin tent, nër të vobeket pa kursím, edhe fitove lavdín' e Perëndisë; pra me shigurí, dollë në shesh o kryetrím, për luftë dhe mundím, Shen Gjerq Dëshmór i Math me nam, edhe u-bërë shok në pësimet dhe në Ngjalljen e Krishtit; dhe Mbretërinë, e trashëgove, dhe nermjetón për të gjithë né.

LAVDI DHE TANI, *e Pesedhjetores.*

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalerisë, shumë pasione më leftojnë,

po ti perkrah-me dhe shpëtome, o Shpëtimtari im.

Ju që urreni Sionen, do të turpëroheni prej Zotit, dhe do të físhkeni si bari në zjarr.

LAVDI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, merr jetë çdo shpirt, dhe lartësohet në paqesí, dhe ndriçohet prej njesisë Trinisore mistikërisht.

TANI. Me anën e Shpirtit të Shenjtë, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tërë krijesën për jetë-lindje.

PARCVARGU. I drejti do të lulëzonjë si feník, edhe do të rritet si dellinja e Libanit.

UNGJILLI I MËNGJESIT PAS LUKAJT

Zoti u-tha Dishépujve: Rúajuni nga njërezit, se do tju kapin, dhe do tju ndjekin, dhe do tju dorëzojnë nëpër sinagoja dhe nëpër burgje, dhe do tju shpien përpara mbréterve dhe princërve për emrin tim. Dhe kjo do tju bëhet për deshmím. Vendosni pra në zemrat túaja të mos parrëmëjtoni se qysh do të mpróheni, se unë do tju jap gojë dhe urtesí, të cilën nukë do të mundin ta përballin kundërshtaret tuaj. Dhe do të dorëzoheni edhe prej prindërve edhe vëllëzërve dhe gjirinjëve dhe miqve, edhe disa prej jush do të vriten, dhe do të jini të urreyer prej të gjithëve për emrin tim, po asnjë qimë e kokës suaj nukë do të humbasë. Do ta zoteroni shpirtin me durimin tuaj.

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nërmjetimet e Athloforit, o mëshirëplót, shúajji paudhesít' e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít' e mia.

Meshirome, o Perendá meshireplót, edhe shúaji paudhesít' e mia.

T. II. Tere krijesa ndrit, dhe Kisha e stolisur, me lulet e prenveres, po i therrét Shen Gjergjit: Perhere nermjetó per né.

SHKURTORJA, T. IV, O IPSOTHIS

Si u-stervite mire prej Shpetimtarit, u-bere bujk i lavderuar i ares, dhe pemet e virtútave i mblodhe me mall; mbolle dyke derdhur lot, kore gas dhe defrime; u-mundove derdhe gjak, dhe fitove Jesunë, me nermjetimin tent o Shenjt i Math, merr per te gjithë, ndjesen e mekátave.

SHTËPIA

More si shëmbell Krishtin, dhe vdiqe si ushtár i tij per njerezine, o Shen Gjerq Deshmór i Math. Pra te lavderojme me bese, si nje mprojtes te palodhur, dhe te lútemi te nermjetósh pa pushuar perpara Perendise, qe te na dhuronje ndjesen e mekátave.

SINAKSARI

Me njezét e tri te ketí múaji, kujtojme Shen Gjergjin e lavderuar, Deshmorin e Math edhe Tropeprúrcsin.

Gjithe sot, kujtojme Valerin, Deshmorin e Shenjte.

Gjithë sot, kujtojme Anatin dhe Protoleon-tin, Dëshmoret e Shenjtë.

Gjithë sot, kujtojme Athanasin e Mágëve, Dëshmorin e Shenjtë.

Gjithë sot, kujtojme Glicerin Bujkun, Dëshmorin e Shenjtë.

Gjithë sot, Shen Donati dhe Shen Therini e mbaruan jetën të vrarë me shpatë.

Me nërmjetimet e tyre, o Perëndi, mëshirona. Amín.

ZBRITCSORET, T. I, ANASTASEOS IMERA

I. Dit' e Ngjalljes sot na ndriti, ngazellóhuni pra, Pashka e Zotit Pashka; se ja prej vdekjes jeta vjen, dhe prej dheut lart në qell, na shpuri me kengë mündese Zoti Krisht, Shpëtimtari i shpërtheve.

III. Eni pini ujë krejt të re, që s' e nxori prej shkëmbit, shkopi çuditërisht, po që burón si rëké, nga varri i Zotit Jesú Krisht, i cili na fal shërim.

IV. Nga fron' i qellit o Profét, perendifoles Abakúm, eja sot me né dhe tregona, dritën edhe Engjëllin, i cili sheshit lajmerón: Sot i ka ardhur shpëtimi botës, se Jesú Krishti u-ngjall, si Perëndi dhe Zot.

V. Mengoni me natë dhe eni, dhe le t' i shpiem këndime, si myrrë Zotit në varret, që ta shohim Zotin Krisht që na ndrit si diell dhe na fal, jetën dhe paqen të gjítheve.

VI. Kur zbrite gjer në funt të dheut në Ferr,

dhe dermove gjithë llozet e burgut, çlirove të gjithë skillevet o Krisht, edhe pas tri ditsh prej balencs si Jonáj, dolle jashtë nga varri.

VII. Tre Djemat midis flagës i mproj me shi, dhe vetë u-bë njeri, dhe pesó j si né, dhe me pesimin shpetimtár, na stolisi me jeten që nukë vdes, i vétëmi Perëndí i bekuar, i Aterve lavdí me ty.

VIII. Dit' e sotme është e shënuar e shenjtë, e para dit' e javës, që mbreterón mi të kremtet, permi dhenc kudó, panáir i panáireve lart në qell; sot pra e bekojme, për jetë Jesú Krishtin.

Një Engjell i therriste, hirplotes pa pushuar, gezohu Virgjereshe, dhe prape të thom gezohu, se Biri yt u-ngjall që prej varrit i triditim.

IX. Ndriçohu ndriçohu, qytét i ri Jerusalém, se lavdia e Zotit, permi ty ka lindur sot. Valle këcé, dhe gezohu Sión, ti o Marí, Nën' e Perëndisë, defré për ngjalljen e Birit tent.

DËRGIMËSORET, T. II, TIS MATHITES

Prenvera na gezón taní, dit' e madhe e Zotit, dhe Ngjallja prej se vdékuresh, na shkëlqén për Pashkë, edhe na shpuri në qellin, tok me té na ka ardhur, edhe e kremt' e ndrícime, e Dëshmorit të Math kryetrím Shen Gjerq, bescrisht e lusim pra që të gjithë, se ashtú vleresóhemi, për Parajsen e Krishtit.

Pastáj e Pesedhjetores.

LAVDGRIMET, T. II, OTE EK TU KSILLU

Passi e kremtuam lavdcrisht, ditën e bekuar të

Pashkes, me brohorí dhe me gas, prapc le ta lusim sot, ditën e ndrícime, te Deshmorit te Math Shen Gjerq, me lul' e kurorc, le ta presim mún-
desin e kryqcsátave, qe me nermjetimet e tija, te fitojme ndihme dhe mprojtje, hirin edhe ndjesen e mekátave.

Veten e blatove ploterísht, i sakrifikove te gjitha, çdo gas dhe çdolumerí, si nje hollokóst te math, te gjall' e plot me shpirt, te pelqyer prej Zotit Krisht, dhe prej Perendise, dhe u-bere nermjetár, per çdo mekát dhe çdo faj, edhe na shpctón nga furtunat, né qe te hymnojme me besc, o Shen Gjerq i lumur o Deshmór i Math.

Faren e lcrove me kujdés, qe te kishte mbjellur ne shpirtin, Zoti Jesú Shpctimtár, dhe e shtove me mundím, me vojtje dhe me deshmím, se me ment e me urtcsi, ne arkat qellore, mblodhe pasurí dhe mall, dhe i gezón taní, ti pra o Deshmór i degjuar, pranc Perendise perkraha, edhe falna ndjesen e mekátave.

Eja o Shen Gjerq Deshmór i Math, edhe nga nevojat e ndryshme, me nermjetím edhe hir, na shpctó dhe na çliró, nga çdo shtrengím dhe rezík, dhe largona prej shpírteve, çdo helm dhe trazire, ndjesen e mekátave, na fal edhe na dhuró, qe te te hymnojme me besc, dhe me brohorí dhe me bujc, o Shen Gjerq i lumur o Deshmór i Math.

LAVDI, T. T. I. Lindi vera, eni te defrejme; shkelqeu Ngjallja e Krishtit, eni te ngazellóhemi; na ardhi dita e Shen Gjergjit, eni ta kremtojme

mistikerisht. Se si nje ushtár i mire, leftój kunder tiráneve dhe i munda, dhe pcsój si Shpetimtari Jesú Krisht; nuk i ardhi keq per enen prej balte, po e çveshi dhe e dermój me vojtje. Atí pra le t'i therresim: Lutu o Deshmór dhe Athlofór, te shpe-tohen shpirtet tona.

TANI. Ardhi dit' e shenjt' e Ngjalljes, le te ndriçohemi prej panairit, edhe eni te pershendóshemi; çpallim sot vllazerí, me sa na kane mcri, le t' i ndejme te gjitha diten e Ngjalljes, dhe le te therresim sot: U-ngjall nga varri Zoti Krisht, me vdekje vdekjen dyke shkelur, edhe te varrósurve, nje jet' u dhurój te re.

HYRTORJA

Ner Kishet e beconi Perendine, Zotin prej bu-rimit te Israelit. Shpctona o i Bir' i Perendise, qe u-ngjalle se vdékuresh, né qe te kendojme, Ali-lluia.

SHKURTORJA, T. T. IV, I KE EN TAFO

O i pavdekur qe zbritte ne varr per né, ti e der-move Sketerren o Zot perdhé, dhe u-ngjalle si fi-timtár o Krisht Perendí, edhe Grave me myrra u thirre Gezóhuni, dhe u dhurove paqen qellore Di-shépujve, ti qe u fale Ngjalljen te réneve.

APOSTULLI

Le te defrenje i drejti me Zotin. Degjoma ze-rin, o Perendí.

Prej Akteve te Apostujve.

M' até kohë, mbreti Heród i kapi dhe i mundó j disá besnikë të Kishes, edhe e vrau me shpatë Jakobin, të vëllanë e Joanit. Edhe kur e pá që kjo gjë u kishte pëlqyer Judenjve, vendosi ta kapë edhe Pjetrin; edhe ishin ditët e Bukës së Pambrujtur; edhe e kapi, dhe e hodhi në burg, edhe vuri kater togje ushtarësh të rúanin, se deshte ta nxirte përpara pópullit pas Páshkëve. Keshtú pra, e rúanin Pjetrin në burg; edhe besnikët e Kishes bënin lutje të nxehta për até. Edhe kur arriu dita, që ta nxirte Herodi përpara pópullit, até natë Pjetri, i lidhur me dy vargónj, po flinte midis dy ushtarësh, edhe gardianet e rúanin burgun përpara derës. Edhe befás ja ku ardhi Engjelli i Zotit, edhe një dritë vetëtiu në até vent, edhe Engjelli e goditi Pjetrin në brinjë, dhe i tha: "Ngrehu shpejt." Edhe menjherë i ranë vargonjtë prej dúarve. Dhe Engjelli i tha perserí: "Veshu dhe mbathu." Dhe Pjetri u-vesh edhe u-mbath. Pastáj Engjelli i tha: "Taní peshtillu me roben dhe eja pas meje." Dhe Pjetri i ra pas, edhe dolli, dhe nukë dinte se ishte e vertetë apo e ndërr. Dhe pasi shkuan rojen e parë dhe të dytë, arrinë në portën e hékurtë, e cila shpinte në qytét, edhe e cila u-hap vetë vetiu; dhe dúallnë me një rugë; dhe befás Engjelli u-largua prej tij. Edhe Pjetri ardhi me vetë, dhe tha: "Taní e di me të vertetë që Zoti më dergó j Engjellin, dhe më

shpctó j nga dora e Herodit edhe nga qellimet e Judenjve.”

UNGJILLI PAS JOANIT

Zoti u-tha Dishépujve: Kjo është porrosia ime, doni njerjatrín. Neqóftese bota ju urrén, díjeni se mua me ka urryer mé pare se ju. Sikur te ishit prej botes, bota do tju deshte si te sajte, po meqéneqe nuke jini prej botes, nga e cila ju kam zgjedhur une, perandáj bota ju urrén. Kujtójeni fjalen, qe ju thashe. Nuke ka sherbetór mé te math se i Zoti. Atá, qe me kane ndjekur mua, do tju ndjekin edhe ju. Atá, qe kane rúajtur fjalen time, do ta rúajne edhe túajen. Edhe ketó te gjitha do tjua bejne per emrin tim, se nuk e njohin até, qe me ka derguar. Sikur te mos kisha ardhur dhe te mos u kisha folur, nuke do te kishin mekát. Po taní nuke kane mehane per mekatin e tyre. Aý, qe me urrén mua, urrén edhe tim-Atë. Sikur te mos kisha bere perpara tyre veprat, te cilat nuk i ka bere asnjé tjater, nuke do te kishin mekát, po taní edhe i kane pare veprat edhe me kane urryer edhe mua edhe tim-Atë. Edhe keshtú mbushen fjalet e shkrúara ne ligjen e tyre, qe me urryen darovísht. Edhe kur te vinje Ngushellimtari, Shpirti i se vertetes, qe dergohet prej Atit, te cilin do tjua dergónj une me anen e Atit, aý do te deshmonje per mua. Po edhe ju deshmoni, se kini qene me mua qe ne krye. Ketó jua thashe, qe te mos skandalizóheni. Do tju nxierin jashte sinagójave, edhe vjen ora, ne te cilen atá,

qe do tju vrasin, do te mburren se i bene nje sher-
bim Perendise.

KUNGATORJA

I drejti do te kujtohet per jete.

*SHENIM. Kur bie Shen Gjergji ne Kreshmet, krem-
tohet gjithenjë pas Pashkes se Madhe.*

24. Elisabeta, Nena jone Oshenare dhe çudibërese.

PERLCSHORJA E ELISABETES OSHENARES, T. T. IV, EN SI MITER AKRIVOS

Ti o Nene pikerisht, u-tregove shembell e Zotit,
se e more Kryqin tent, dhe pasove Zotin Krisht,
dhe vepra çfaqe per mcsim, qe te çkujdësemi per
trup, se shkon me nxitim, dhe te kujdësemi per
shpirt, se eshte i pavdekur; pra shpirti yt po ge-
zohet tok me Çngjajte, Elisabët' e Shenjte lav-
dí me ty.

25. Shen Marku Ungjillori.

PERLCSHORJA E SHEN MARKUT, T. III.

Shen Mark Apostull dhe Ungjillor, lutju Zotit
tone Jesú Krisht, tu fale shpírteve tona, ndjesen
e mekátave.

THIRRTORET, T. T. IV, TI IMAS.

Si te te levdojme o Apostull? Si nje qell qe na
tregove, çdo lavdí te Zotit Krisht; shkrepçim qe
e shkelqeve, tere boten me ndriçim; si re e cila
derdhi shi prej qiellit; si ene plot me vere te çu-
dícime, qe u jep dçfrim dhe urtesí, zémrave dhe

gjithë shpërteve. Te lútemi, nermjetó per né dhe na shpetó.

Si te te levdojme, o Apostúll? Meshetár per sakramentat, perendore te Jesújt; themeltár i Krishterimit, qe në Kishen predikón; qe pllakat ke latuar te kumándave, qe ligjen ke perhapur, dhe nje hir te ri, qe nga Sión' e Proféteve, e prokllamove o Ungjillór. Te lútemi, nermjetó per né dhe na shpetó.

Si te te levdojme o Apostúll? Si thesár te pasurive, te panúmerta në qell; a si mjek a si sheronjes, per çdo zemer dhe çdo shpirt; si shokun e Shen Pjetrit dhe leçitesin, e dógmave te mirelajmerúara; tituj ke te shum' o Shen Mark, dhe je nje pus i virtútave. Te lútemi, nermjetó per né dhe na shpetó.

Si te te levdojme o Apostúll? Si Dishepull qe leçite, Shpetimtarin Jesú Krisht; si nje mjek qe pasionet, i sherón per çdo besník; si diell shpirtëror qe na ndriçón me gas; kollonc dhe themél i gjithë Kísheve; ti qe na e shkrove o Mark, Ungjillin e Zotit Jesú Krisht. Te lútemi, nermjetó per né dhe na shpetó.

Si te te levdojme o Apostúll? Meshetár i urtesise, i vertete dhe besník, ti na shkrove na leçite, çdo mesím dhe porrosí, kollón' e gjithë Kísheve te Zotit Krisht, keshtjéll' e patronditur e besníkeve. Te shuma dhe te panúmerta dhuratat e doktrínave. Te lútemi nermjetó per né dhe na shpetó.

LAVDI, T. II. O Ungjillór Shen Mark, o Apo-

stúll i Shenjte, pasonjes i Shen Pjetrit, qe na leçite fjalet, e Zotit tone Jesú Krisht.

PASVARGJET, T. T. IV, O TU PARADOKSU

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Aý qe ishte m' i ri, na u-çfaq Apostúll i math, Ungjillór i Kísheve, shpctimtár i njéresve; me predikime, kombet i kthen ne fe, me tonje Kryqi, boten perpjét' e ngre. Oh ç' fare gjah te math, na i solli Zotit Krisht ky Shenjt i Math! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Na e dergój Zot' i Math, Ungjillorin Shen Mark me nam, dele midis újqerve, po aý nuk u-tremp aspák; bishat i beri, shqerra me bes' e fe, boten e tere, me predikim e ndroj. Sa vepra pa tregim, na ke ber' o Apostúll i Zotit Krisht! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

Ç' eshte kjo çudí dhe kjo habí! Si pus per né po burón, uj' e vala me urtesí, per te gjithë njérezit, Ungjillori i Zotit Krisht; prej tij doktrinát, rjedhin posi luménj, hir dhe shcrime, kunder lengátave. Se vepra me lavdí, dhe çudí ke bere o Shen Mark me nam! Pra até e lusim sot, me brohorí dhe mall.

LAVDI, T. II. Ejani sot ketú, Shen Markun ta kremtojme, se predikój Ungjillin, perhapi Krish-terimin, si Apostúll dhe Ungjillór.

LAVDI DHE TANI, e *Pesedhjetores*.

NDENJGSORE, T. I, TON TAFON SU

I Shenjti Apostull, qe na shkrove Ungjillin, dhe boten e ndriçon, me mesimet e tua, Shen Mark i madhi Apostull, Ungjillór dhe Patrik me nam, te nderojme pra, me hymne dhe melodira, dhe te lútemi, qe te na falen mekatat, te gjithë besníkeve.

LAVDI DHE TANI, *e Pesedhjetores.*

T. T. I, TON SINANARKHON

Apostullin Shen Mark le ta lavderojme sot, Ungjillorin e Fjales edhe leçítcsin, predikónjcsin e kómbeve kudó mi dhé, se na mesój dhe na tregój, si ta njohim Zotin Krisht te vétemin Bir te Zotit, dhe nermjetón prane tij pa prere, per shpctimin e besníkeve.

LAVDI DHE TANI, *e Pesedhjetores.*

SHKALLESA KREMTORE, T. IV

Qe prej djalerise, shume pasione me leftojne, po ti perkrah-me dhe shpctome, o Shpctimtari im.

Ju qe urreni Sionen, do te turperóheni prej Zotit, dhe do te físhkeni si bari ne zjarr.

LAVDI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, merr jete çdo shpirt, dhe lartcsohet ne paqcsí, dhe ndriçohet prej njesise Trinisore mistikerisht.

TANI. Me anen e Shpirtit te Shenjte, rjedhin burimet e hirit, dhe vaditin tere kriesen per jete-lindje.

PARCVARGU. Fama e tij u-perháp ne te-re boten.

UNGJILLI I MËNGJJEZIT PAS MARKUT

Zoti tha: “Aý, qe dó te vinje pas meje, le ta monje veten e tij, dhe le ta ngrere Kryqin e vete, dhe le te me bjere pas. Se aý, qe dó ta shpetonje jeten e vete, do ta humbase; po aý, qe do ta humbase jeten e vete per mua dhe per Ungjillin, aý do ta shpetonje. Se ç’ dóbi do te kete njeriu, ne fitofte boten e tere dhe ne humpte shpirtin e vete? Se nuke ka çmim, me te cilin ta bleme shpirtin prape. Pra, kush te kete turp per mua dhe per fjalet e mia ne keté brez mekatár, edhe i Biri i njeriut do te kete turp per até, kur te vinje me lavdine e Atit, i rethuar prej Çngjajeve te Shenjte.” Edhe u thoshte: “Me te vertete po ju them se disa prej atyre, qe ndodhen ketú, nuke do ta ngjerojne vdekjen, po do ta shikojne te gjalle Mbretesine e Perendise, kur te vinje me fuqí.”

Psalmi 51 pa ze.

LAVDI. Me nermjetimet e Apostullit, o meshireplót, shúaji paudhesít’ e mia.

TANI. Me nermjetimet e Hyjlíndeses, o meshireplót, shúaji paudhesít’ e mia.

Meshirome, o Perendí meshireplót, edhe shúaji paudhesít’ e mia.

T. II. O Ungjillór Shen Mark, leçites i degju-

ar, shpetona nga reziket, nga helmet e lengatat, dhe grackat e demóneve.

SHKURTORJA, T. IV, EPEFANIS SIMERON

O Shen Mark o Apostúll, i Shpetimtarit, ndrite me Shen Pjetrin tok, te gjithe njërezit mi dhé, dhe erresiren e çduke krejt, kur e perhape, Ungjillin e Zotit Krisht.

SHTËPIA

Si Dishepull i Shen Pjetrit, edhe leçites i Shpetimtarit, i shgurove te tronditurit permi shkembin e se vertetes. Te lútemi pra, shpetona nga leçet e armikut, tregona driten e shpetimit, se ti e ke ndritur tere boten, kur e perhape Ungjillin e Zotit Krisht.

SINAKSARI

Me njezét e pese te ketí múaji, kujtojme Shen Markun, Apostullin dhe Ungjillorin.

Gjithe sot, kujtojme Makedonin, Atin tone te Shenjte, Patrikun e Kostandinopjes.

Gjithe sot, kujtojme Niken, Deshmorin e Shenjte.

Gjithe sot, kujtojme te Tete Oshenaret, Anako-retet edhe Deshmoret e Shenjte.

Me nermjetimet e tyre, o Perendí, meshirona. Amín.

ZBRITESORET, T. I, ANASTASEOS IMERA

I. Dit' e Ngjalljes sot na ndriti, ngazellóhuni

pra, Pashka e Zotit Pashka; se ja prej vdekjes jeta vjen, dhe prej dheut lart ne qell, na shpuri me kenge mundese Zoti Krisht, Shpetimtari i shpírteve.

III. Eni pini uje krejt te re, qe s' e nxori prej shkembít, shkopi çuditerisht, po qe burón si reké, nga varri i Zotit Jesú Krisht, i cili na fal sherím.

IV. Nga fron' i qellit o Profét, perendifoles Abakúm, eja sot me né dhe tregona, driten edhe Engjellin, i cili sheshit lajmerón: Sot i ka ardhur shpetimi botes, se Jesú Krishti u-ngjall, si Perendí dhe Zot.

V. Mengoni me nate dhe eni, dhe le t' i shpiem kendime, si myrre Zotit ne varret, qe ta shohim Zotin Krisht qe na ndrit si díell dhe na fal, jeten dhe pagen te gjítheve.

VI. Kur zbrate gjer ne funt te dheut ne Ferr, dhe dermove gjithë llozet e burgut, çlirove te gjithë skllevet o Krisht, edhe pas tri ditsh prej balesnes si Jonáj, dollë jashte nga varri.

VII. Tre Djemat midis flages i mproj me shi, dhe vete u-be njerí, dhe pesój si né, dhe me pesímin shpetimtár, na stolisi me jeten qe nuke vdes, i vétemi Perendí i bekuar, i Aterve lavdí me ty.

VIII. Dit' e sotme esht e shenuar e shenjte, e para dit' e javes, qe mbreterón mi te kremtet, permi dhene kudó, panaír i panaíreve lart ne qell; sot pra e bekojme, per jete Jesú Krishtin.

Nje Engjell i therriste, hirplotes pa pushuar, gezohu

*Virgjereshe, dhe prape te thom gezohu, se Biri yt u-ngjall
qe prej varrit i tridicim.*

IX. Ndricohu ndricoju, qytét i ri Jerusalém, se lavdia e Zotit, permi ty ka lindur sot. Valle kecé, dhe gezohu Sión, ti o Marí, Nen' e Perendise defré per ngjalljen e Birit tent.

DGRGIMCSORET, T. III, EPESKEPSATO

Si nje bir i Pjetrit Math, te parit te Dishépujve, fitove hir dhe pasurí, dhe i perndave pa kursím, edhe i pari ne Misír, Ungjillin e lecite, dhe ndrite Egíptasit.

Pastáj thuhet e Pesedhjetores.

LAVDGRIMET, T. I, TON URANION

Ne tere dhen' u-degjua nami yt o Shen Mark, o Apostúll i lumur, qe perhape Ungjillin, dhe dogmen Orthodoxe qe na leçit, Atin Birin dhe Shpirtin Shenjt, qe adhurojme te gjithë mistikerisht, si Trinín' e bashkeqénshime.

Si Ungjillór te shkelqyer te Zotit Jesú Krisht, dhe si nje yll te ndricim t' orizontit te Kishes, te quajme te gjith' o Mark Ungjillór, dhe nga shpirti ndricohemi, se nermjetón dhe na fal gjithenjë shpetím, edhe ndjese te mckátave.

E more Kryqin mi supet si na tha Zoti Krisht, dhe dolle faqebardhe dhe fitove kuroren, me djerse dhe mundime Mark Ungjillór, dhe keshtú trashegón ne qell, Parajscn tok me Shenjtoret dhe nermjetón, per shpetimin e besnikëve.

LAVDI, T. T. II. Buzet te derthne hir, o Un-

gjillór i Shenjte, edhe Barí u-bere, edhe kudó le-cite, nje Perendí dhe nje Triní.

TANI, e *Pesedhjetores*.

HYRTORJA

Ner Kishet e bekoní Perendine, Zotin prej bu-
rimit te Israelit. Shpetona o i Bir' i Perendise, qe
u-ngjalle se vdékuresh, né qe te kendojme Ali-
lluia.

SHKURTORJA, T. T. IV, I KE EN TAFO

O i pavdekur qe zbrite ne varr per né, ti e der-
move Sketerren o Zet perdhé, dhe u-ngjalle si
fitimtár o Krisht Perendí, edhe Grave me myrra
u thirre Gezóhuni, dhe u dhurove paqen qellore
Dishépujve, ti qe u fale Ngjalljen te réneve.

APOSTULLI

Fama e tij u-perháp ne tere dhene. Qelli tregón
lavdine e Perendise.

Prej Letres I se Pergjithme te Pjetrit.

Vellezer, perúnjuni nene doren e forte te Pe-
rendise, qe tju lartesonje me kohe. Lérjani atí te
gjitha kujdesjet túaja, se ay interesohet per ju.
Rrini esell, dhe vigjelloni, se djalli, armiku juaj,
ulerín si luán, edhe shetít, edhe kerkón te gellti-
te nonjë nga ju; até kundreshtójeni, dhe qendro-
ni te patundur ne bese, dyke ditur qe keshtú po
perpiqen, edhe vúajne te gjithë vellézerit tuaj ne
botë. Dhe Perendia, i cili dhurón çdo hir, dhe i ci-

li ju thirri në lavdine e perjetme të Jesú Krishtit ju, që kini pesuar pak, aý ju stervitë, ju perkrahë, ju forcoftë, dhe ju themeloftë. E atí është lavdia dhe fuqia në jetet e jéteve. Amín. Ju shkrova me pak fjale me anën e Silvanit, vellájt tonë besnik, ashtú si e gjykónj punën, edhe ju shigurónj edhe ju dëshmónj që ky hir, në të cilin qëndroni, është me të vertetë i Perëndisë. Besniket e Kishes në Babilloní dhe Marku, im-bir, ju dergojnë të fala. Përshëndoshni njerjatrën me puthje dashurie. Paqë mi ju të gjithë që jini me Krishtin Jesú.

UNJILLI PAS LUKAJT

Zoti u-tha Dishépujvë: “Aý, që ju degjón ju, me degjón mua; dhe aý, që ju perbúz ju, me perbúz mua; dhe aý, që me perbúz mua, perbúz até, që me ka derguar.” Edhe të Shtatedhjetet u-kthyen prapë me gas, edhe i thanë: “O Zot, edhe demonet na binden me emrin tënt.” Edhe Jesúj u tha: “E pashe Satanin që u-vezua nga qelli si rufé. Ja ku ju jap fuqí të shkelni mi gjerperínj edhe agrepe dhe mi tërë poteren e armikut, edhe asgjé nukë do tju benjë dem. Po mos u-gezoni për këtë, që frymat ju binden, po u-gezoni me tëper që emrat túaja janë shkruar në qell.” Edhe m’ até orë, Jesújt iu-gezua shpirti, dhe tha: “Të perhirónj, o Atë, o Zot i qellit edhe i dheut, që këtë ua ke fshehur të úrteve dhe të ménçurve, dhe ua ke zbuluar fóshnjave. Po, o Atë, se ashtú të pelqeu mé mirë.”

KUNGATORJA

Fama e tij u-perháp ne tere boten.

SHENIM. Si Shen Gjergji, ashtú edhe Shen Marku, kur bie ne Kreshmet e Medhá, kremtohet pas Pashkes.

26. Basileu, Hierodeshmori i Shenjte, peshkopi i Amasise.

27. Simeoni, Hierodeshmori i Shenjte, Kusheriri i Krishtit, peshkopi i Jerusalemit.

PERLGSHORJA E SIMEONIT TG JERUSA-
LEMIT, T. I, KHOROS ANGELIKOS

Gjirí me Zotin Krisht, Simeón i bekuar, shkelqeve si Deshmór, perandáj te hymnojme, se shtype çdo heresí, edhe besen e ngrite lart, sot pra mblídhemi, dhe te kremtojme me besë, dhe te lútemi, te na dhurósh perdellím, dhe ndjesen e mekátave.

28. Te Nente Deshmoret e Shenjte te Kizikes.

29. Jasoni dhe Sosipatri, Apostujte e Shenjte.

30. Jakobi, Apostulli i Shenjte, i velláj i Shen Joán Theollogut.

PERLGSHORJA E JAKOBIT APOSTULLIT,
T. III.

Jakób Apostúll i Shenjte, lutju Zotit tone Jesús Krisht, tu fale shpírteve tona, ndjesen e mekátave.